



REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA GLLOGOC GLOGOC MUNICIPALITY			
Pranuar		20. 09 19	
Nj. Crg.	Numër	Shtojca	Vlera
01	400	55472	



KOMUNA DRENAS
OPSTINA DRENAS
THE MUNICIPALITY OF DRENAS

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



Qendra e Rehabilitimit e Bazuar ne Bashkësi
Handikos – Drenas

Duke u bazuar në nenin 5, 13, dhe 58, të Ligjit Nr-03/L-040, mbi Vetëqeverisje Lokale, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008), dispozitave të Statutit të Komunës së Drenas-it, 01-Nr-8336 të datës 04.11.2008, Rregullorës MF - Nr – 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, Vendimit Nr. 12.400.43540 të datës 30.07.2019, Kryetari i Komunës së Drenas-it, lidhë këtë:

MARRËVESHJE E MIRËRKUPTIMIT PËR FINACIM

E hartuar me datën 16/09/2019, e lidhur mes palëve:

1. Komuna e Drenasit- përfaqësuar nga Ramiz Lladrovci–Kryetar i Komunës , (në tekstin e mëtejme Komuna) dhe
2. Organizata e Përsonave me Aftësi të Kufizuara “Handikos” me seli në Drenas, rr. Xhevat Demaku Nr.72 , përfaqësuar nga Menaxheri Behxhet Binaku nga Drenasi.

Neni 1.

Qëllimi i marrëveshjes

Qëllimi i kësaj marrëveshje të mirëkuptimit është mbështetja me mjete financiare Organizatën e Personave me Aftësi të Kufizuara “Handikos”, në implementimin e projektit “ Sherbime Sociale dhe Rehabilituese të Bazuara në Bashkësi për fëmijë dhe të rritur me aftësi të kufizuara fizike dhe të kombinuara” e që ka të bëjë me rehabilitimin terapisë primare fizikale dhe edukimit social (psiko-social) të personave me aftësi të kufizuara, me theks të veçantë fëmijëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuara.

R L

Neni 2

Obligimet e Komunës

2.1 Komuna do të përkrah zhvillimin e aktiviteteve në Organizatën e Personave me Aftësi të Kufizuara “Handikos” përmes mbulimit të shpenzimeve për ofrimin e shërbimeve të rehabilitimit për personat me aftësi të kufizuara në shumën financiare në vlerë të përgjithshme prej **10.000,00 €** (dhjetë mijë Euro) nga planifikimi i buxhetit të vitit 2019.

2.2 Komuna do të monitoroj procesin e shfrytëzimit të mjeteve dhe destinimin e tyre, do të caktoj menaxherin e projektit me vendim të vecantë. Raportimi i Menagjerit lidhur me projektin e lartëshënuar bëhet së paku një herë në vit.

2.3 Transferi i mjeteve financiare bëhet në bazë të Vendimit të Kuvendit të Komunës së Drenasit.

2.4 Komuna i zotën dhe transferon mjetet në shumë financiar prej **10.000.00 €** , për kryerjen e shërbimeve nga personeli i angazhuar në Organizatën e Personave me Aftësi të Kufizuara “Handikos”, mjetet lëshohen në xhirollogarinë e Organizatës së Personave me Aftësi të Kufizuara “Handikos” me seli në Drenas, në NLB Bank, me nr. të llogarisë: 1701001012698353.

Neni 3

Obligimet e “Handikos-it”

3.1 Organizata e Personave me Aftësi të Kufizuara -“Handikos” në Drenas, merr për obligim implementimin e projektit të cekur në neni 1, të kësaj marrëveshje për financim, por edhe të projekteve tjera në të mirë të personave me aftësi të kufizuara.

3.2 Përfituesi , përkatësisht Organizata e Personave me Aftësi të Kufizuara -“Handikos” raporton te zyrtari monitorues, në baza të rregullta, lidhur me zbatimin e projektit/programit .

Neni 4

Raportimi me shkrim

“Organizata e Personave me Aftësi të Kufizuara “Handikos” në Drenas, në bashkëpunim me organin mbikëqyrës të Komunës merr për obligim që pas përfundimit të të gjitha procedurave dhe realizimit të projektit të cekur në nenin 1, të kësaj marrëveshje të përgatitin **raport me shkrim financiar dhe narrativ** për Komunën e Drenasit, në total për mjetet e financimit për realizimin e projektit, duke i justifikuar me kontrata të ndryshme, faktura dhe dëftesa, përkatësisht kupona në pajtueshmëri me rregullat-procedurat financiare.

Neni 5

Kohëzgjatja e marrëveshjes

Kjo marrëveshje e mirëkuptimit për financim fillon të implementohet-zbatohet për vitin 2019/2020, me mundësi vazhdimi.

R. L.

Neni 6
Zgjidhja e marrëveshjes

Palët zotohen se do t'i përmbahen kësaj marrëveshje të mirëkuptimit për financim dhe se në rast kontesti eventual apo paqartësie në tekstin e kësaj marrëveshje, të zgjidhen me anë të bisedimeve, konsultimeve miqësore dhe me mirëkuptim, në të kundërtën kompetent do të jetë Gjykata Themelore në Prishtinë, Dega në Drenas.


Neni 7
Numri i kopjeve


Kjo marrëveshje e mirëkuptimit për financim është e hartuar në 5 ekzemplarë identik, nga një për secilën palë, kurse të tjerat mbesin për nevojat e organit kompetent.


Neni 8
Hyrja në fuqi

Marrëveshja e mirëkuptimit për financim fillon të zbatohet nga dita e nënshkrimit nga palët kontraktuese.

PALËT NË MARRËVESHJE


Kryetar i Komunës
Ramiz Hladovci




Përfaqësuesi i "Handikos"
Behxhet Binaku

